



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNİ PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.12/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët, Hidajete Gashi Alaj kryesuese, Kujtim Pasuli dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së [REDAKTUAR] nga Rahovica Komuna Ferizaj, të parashtruar ndaj vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me nr. Protokoli 01/2318/2025 datë 03.09.2025, për Miratimin e rekomandimit për refuzimin e kundërshtimit administrativ në lidhje me aplikimin për regjistrim të votuesve jashtë Kosovës, për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 06.09.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.12/2025, datë 04.09.2025, e parashtruar nga [REDAKTUAR] nga Rahovica Komuna Ferizaj, kundër Vendimit me nr. Protokoli 01/2318/2025 datë 03.09.2025, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të mos regjistrimit si votues jashtë Kosove për Zgjedhjet Lokale të Republikës së Kosovës që do të mbahen me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 04.09.2025, PZAP-i, përmes emailit zyrtar ka pranuar një ankesë nga [REDAKTUAR] nga Rahovica Komuna Ferizaj, me të cilën pretendon se të njëjtit i është refuzuar ankesa për kundërshtim administrativ për tu regjistruar si votues jashtë Kosovës, i cili ka aplikuar në faqen zyrtare të KQZ-së, me kërkesë që të votojë jashtë Kosovës, përmes platformës elektronike. Parashtruesi thekson se i'u është refuzuar kërkesa me arsyetimin "Mungon fotografia juaj me dokument identifikues të Kosovës në dorë". Parashtruesi në ankesë thekson se ka ofruar dëshmi shtesë të vlefshme, të cilat e vërtetojnë adresën e vendbanimit në Kosovë. Megjithatë, pavarësisht dorëzimit të këtyre dëshmive të plota dhe të ligjshme, KQZ nuk e ka pranuar aplikimin e tij, duke ia pamundësuar të drejtën kushtetuese dhe ligjore për të ushtruar të drejtën e votës. Ky veprim përbën shkelje të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 6 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme, ku përcaktohet e drejta universale e qytetarëve të Kosovës për të votuar.

Parashtruesi në ankesë ka bashkangjitur dëshmitë fotografinë e tij, në të cilën ai mban në dorë dokumentin e tij të identitetit të Republikës së Kosovës.

PZAP, me datë 05.09.2025 ka parashtruar kërkesë për përgjigje në ankesë KQZ-së lidhur me ankesën ZL.Anr.12/2025 të parashtruar nga ankuesi [REDAKTUAR]

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me datë 05.09.2025 ka kthyer përgjigje në kërkesë në PZAP.

Në përgjigje në kërkesë të KQZ-së, ndër të tjera thuhet se Shtetas [REDAKTUAR] (më tej parashtruesi i ankesës), me numër personal të Republikës së Kosovës [REDAKTUAR] ka aplikuar përmes platformës elektronike. Shërbimi për votues ka shqyrtuar aplikimin dhe aplikuesi është njoftuar përmes emailit, në email adresën e dhënë gjatë aplikimit [REDAKTUAR] për refuzimin e aplikimit të tij me arsyen e refuzimit: "Mungon fotografia juaj me dokument identifikues të Kosovës në dorë", meqë dëshmia e bashkangjitura nuk vërehej asnjë e dhënë në të dhe si e tillë nuk plotësonte kërkesat e përcaktuara me rregulloren sikurse përcaktohet në nënparagrafin 4.5, të nenit 3, të Rregullores Zgjedhore Nr.04/2025, Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës, ku thuhet: "4.5.bën verifikimin e dyfishtë të identitetit të votuesit përmes fotografimit në kohë reale gjatë aplikimit ku shihet fytyra e tij/saj dhe mbanë në dorë dokument identifikues të Republikës së Kosovës, apo përmes skanimit biometrik me njohje të fytyrës."

KQZ ka themeluar Komisionin për Kundërshtim Administrativ (Komisioni), i cili ka shqyrtuar të gjitha kundërshtimet e pranuar, përfshirë edhe atë të paraqitur nga votuesi. Pas vlerësimit të dokumentacionit dhe pretendimeve, Komisioni konstatoi se aplikimi nuk i plotëson kushtet formale, sepse: gjatë aplikimit nuk janë dorëzuar dëshmitë e kërkuara; dhe adresa e emailit e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit dhe nuk është adresë personale, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 "Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës", ku kërkohej që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil.

Mospërmbushja e këtyre kërkesave pengon verifikimin e identitetit dhe komunikimin me aplikuesin; për rrjedhojë, Komisioni ka rekomanduar refuzimin e kundërshtimit administrativ të votuesit si të pabazuar në kushtet e rregullores.

Paneli, pas shqyrtimit të ankesës së parashtruar nga ankuesi, gjeti se:

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli e vlerësoj lejueshmërinë e ankesës dhe ka arritur në përfundim se e njëjta i plotëson kushtet e përcaktuara me nenin 98 paragrafi 3 të Ligjit NR.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe në nenin 4 të Rregullores për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave,

Paneli, pasi shqyrtoi shkresat e lëndës dhe vendimin nr. 01/2318/2025 datë 03.09.2025 të KQZ-së, konstatoi se i njëjti është i drejtë, dhe i ligjshëm, bazuar në këtë vlerësoi se ankesa është e pabazuar, pasi që parashtruesi i ankesës gjatë aplikimit të tij për regjistrim për votim jashtë Kosovës nuk i ka plotësuar kriteret e kërkuara sipas nenit 3 nenparagrafi 4.2 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së,

në të cilin nen të të njëjtës Rregullore ndër të tjera thuhet se *“Kërkesa për regjistrim përmes platformës elektronike të KQZ-së bëhet duke plotësuar dhe bashkangjitur: Plotëson email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal;*

Nga shkresat e lëndës, si dhe nga përgjigja e KQZ-se, Paneli vlerësoi se parashtruesi i ankesës në momentin e aplikimit për regjistrim për votim jashtë Kosovës, përmes platformës elektronike të KQZ-së, pavarësisht faktit që aplikuesi kishte bashkangjitur disa dokumente të kërkuara, ai nuk ka plotësuar një nga kriteret e rëndësishme email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal, adresa e emailit e përdorur nuk përputhet me të dhënat e votuesit dhe nuk është adresë personale, në kundërshtim me nënparagrafin 4.2 të nenit 3 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025 “Regjistrimi dhe Votimi Jashtë Kosovës”, ku kërkohej që aplikuesi të plotësojë adresën personale të emailit dhe numrin personal të telefonit mobil. Po ashtu neni 5 paragrafi 5.1 i kësaj Rregullore parasheh që: “Formularin e Regjistrimit, të plotësuar dhe të nënshkruar me të dhënat personale të votuesit, përfshirë: adresën e banimit jashtë Kosovës, email adresën personale dhe numrin e telefonit personal).” Në aplikimin e tij, parashtruesi i ankesës kishte bashkangjitur një foto në dorë me dokumentin identifikues të Republikës së Kosovës.

Megjithatë, përveç këtyre dokumenteve, sipas procedurave të KQZ-së, kërkohej verifikim që aplikuesi të vendos email adresën personale dhe numrin e telefonit mobil personal. Ky kriter specifikon që aplikuesi duhet të vendos në platforme email adresën e vet personale.


Në rastin konkret, aplikuesi gjatë aplikimit nuk e ka plotësuar kërkesën për regjistrim jashtë Kosovës për kriteret e vendosura sipas KQZ-së dhe kjo ka rezultuar në mos plotësimin e kriterëve të rregulluara me Rregulloren Zgjedhore Nr. 04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës të KQZ-së.

Prandaj, nga arsyet e theksuara më lart si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 117 paragrafi 3, 118 paragrafi 1, neni 119 paragrafi 3 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, neni 3.3.1 të Rregullores Zgjedhore Nr. 04/2025, për Regjistrimin dhe Votimin jashtë Kosovës, neni 10 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL Anr. 12/2025 më datën 06.09.2025

Kryesuese e panelit

Hidajete Gashi Alaj

The image shows a circular official stamp of the Panel for Complaints and Petitions. Overlaid on the stamp is a handwritten signature in dark ink, which appears to be 'H. Gashi Alaj'.

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.